

Nr. 34 Prot.

Nr. ____ Prot.

Tiranë 20.12.2023

Tiranë _____.2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

Universiteti Barleti (UniBa) Institucion i Arsimit të Lartë, me adresë në rr. Frang Bardhi, Nr. 118, Tiranë, përfaqësuar nga Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë Prof. Assoc. Dr. Mateo Spaho.

Dhe

British American Tobacco Albania, me numer NIPT K12218001E me adresë tek Rruga e Kavajes, Ish Kombinati Ushqimor, Tirane, përfaqësuar nga Administratori, Z. Klodian Cici.

(secila prej tyre, këtu e më poshtë, referuar si "Pala" dhe të dyja sëbashku "Palët") bien dakord për të nënshkruar këtë Marrëveshje Bashkëpunimi si më poshtë vijon:

Duke qenë se:

KOMPANIA British American Tobacco Albania (BAT)

është aktive në fushën e shitjes dhe marketingut, nje partner zhvillimor i ekonomise dhe sipermarrjes, ne industri, qe ka një rritje profesionale dhe aplikim të të gjithë metodave dhe strategjive të suksesshme në fushën e sipermarrjes dhe menaxhimit, duke i dhënë shance dhe mundësi karriere stafit dhe të rinjve, duke permiresuar mireqenien dhe rritur punesimin.

Dhe

Universiteti Barleti (UniBa) Institucion i Arsimit të Lartë,

Në funksion të:

- nevojave për zhvillimin e programit dhe procesit mësimor si dhe realizimin e programit kërkimor e shkencor në fushat e Menaxhimit, Marketingut, Financës dhe teknologjise se Informacionit dhe Inovacionit,
- lidhjes së kërkimit shkencor me veprimtaritë e lidhura me fusha ekonomike tëmenaxhimit, marketingut, finances (bankare dhe jobankare), private dhe industrinë;

- rritjes së angazhimit dhe veprimtarive në ndihmë të komunitetit;

shprehin interesin për vendosjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit mes tyre.

Neni 1

Qëllimi dhe Objekti

1. Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e bashkëpunimit mes institucioneve firmëtare, duke përcaktuar detyrimet e secilës palë.
2. Palët në bashkëpunim me njëra-tjetrën, dhe në masën që nuk cënon ndërsjelltas interesat dhe veprimtaritë e tyre, me qëllim realizimin e programeve të përbashkëta dhe me interes të ndërsjelltë, mirëpresin dhe marrin përsipër:
 - a. Organizimin e vizitave të ndërsjellta, asistencës së studentëve dhe të praktikave të tyre mësimore; të stafit akademik dhe mbështetës të Universitetit Barleti (UniBa), si dhe në njëjtën kohë të punonjësve dhe specialistëve të këtij të fundit në Universitetin Barleti (UniBa).
 - b. Pjesëmarrje në leksione, konferenca dhe aktivitete të tjera të fushës;
 - c. Bashkëpunimin dhe pjesëmarrje në projekte, trajnime, workshope, forume, konferenca, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj.;
 - d. Organizimi dhe mediatizimi i aktiviteteve të përbashkëta;
3. Në mënyrë më specifike "BAT" do të tregojë angazhimin e vet për të ofruar mundësi intershipi, trainimi, studimesh, apo edhe rekrutim të punonjësve të rinj të diplomuar në fakultetin e Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë të UniBa.

Neni 2

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Palët në bashkëpunim me njëra-tjetrën, dhe në masën që nuk cënon ndërsjelltas interesat dhe veprimtaritë e tyre, bien dakord të bashkëpunojnë në çdo kohë dhe ta shtrijnë këtë bashkëpunim në të gjitha fushat e veprimtarisë së tyre. Ato janë të gatëshme që të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për realizimin e shërbimeve, trajnimeve, ofrimin e ekspertizës e konsulencës shkencore dhe pjesëmarrjen në veprimtari të përbashkëta, me qëllim realizimin e programeve të përbashkëta dhe me interes të ndërsjelltë.

Palët në bashkëpunim me njëra-tjetrën, dhe në masën që nuk cënon ndërsjelltas interesat dhe veprimtaritë e tyre, lidhin këtë marrëveshje për të lehtësuar marrëdhëniet ndërinstitucionale për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve, me synim krijimin e mundësive për trajnime dhe intershipe për studentët, komunikimin dhe shkëmbimin e informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Kjo marrëveshje shërben si bazë bashkëpunimi dhe nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë marrëveshje nuk cënojnë apo ndikojnë tek të drejtat dhe detyrimet që i burojnë këtyre palëve nga kontrata/marrëveshje të tjera, apo nga legjislacioni në fuqi.

Palët njohin kërkesën për shkëmbimin e informacionit, personelit akademik dhe studentëve, bashkëpunimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, në bashkërendim me ligjin, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të tyre.

Palët shprehen të gatshme të asistojnë njëra-tjetrën, brenda mundësive të tyre dhe në respekt të politikave, procedurave dhe standardeve teknike, etike, mjedisore, shëndetësore e ligjore që garantojnë mbarëvajtjen e veprimtarive të tyre, në kuadër të zhvillimit të veprimtarive të përbashkëta, për qëllime studimore dhe shkencore.

Neni 5

Palët njohin paraprakisht se kjo Marrëveshje nuk është një kontratë, por përbën një dokument sipas të cilit palët deklarojnë paraprakisht vullnetin e tyre të lirë për një bashkëpunim në realizimin e projekteve dhe veprimtarive të përbashkëta.

Neni 6

Palët janë të vetëdijshme se çdo bashkëpunim i mundshëm në të ardhmen do të jetë subjekt i protokolleve të veçanta, të cilat do të rregullojnë në mënyrë specifike detajet e bashkëpunimit në fjalë.

Neni 7

Personat e kontaktit për palët

Palët për zbatimin e kësaj marrëveshjeje caktojnë nga një person kontakti/koordinator për secilin institucion, të cilët do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e të dy institucioneve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Personi i kontaktit për UniBa do të jetë Dr. Aelita Mani me adresë e-mail; fin.dep@umb.edu.al
Ndërsa personi i kontaktit për kompaninë do të jetë Drejtorja e BNJ, Irida Kovi me adresë e-mail: irida_kovi@bat.com.

Neni 8

Dispozita të fundit

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e firmosjes nga përfaqësuesit e të dyja palëve në datën 20/ 12/ 2023.

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pakufizuar dhe mund të prishet nga palët me anën e një njoftimi paraprak me shkrim të palës tjetër jo më pak se 1(një) muaj para.

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve firmëtare, të shprehur në një dokument të shkruar



Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord:

British American Tobacco Albania
Administrator

Klodian Cici

Universiteti Barleti
Dekan

Prof. Assoc. Dr. Mateo Spaho